



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Nr. 355 Prot.

Tiranë më 18.12.2015

PROCES-VERBAL

Mbledhja e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së

Sot, në datën 18. 12. 2015 në orën 14:00, në ambientet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile më tej AMShC, u mbajt mbledhja e radhës e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së. Rendi i ditës, sipas njoftimit paraprak të Kryetarit të Bordit parashikonte:

1. Propozim, votim dhe miratim të strukturës së menduar për AMShC- në;
2. Çështje të tjera;

Verifikohet prania e Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC-së z. Andi Kananaj, si edhe e anëtarëve të Bordit me numër të nevojshëm për plotësimin e kuorumit për vendimmarrje.

Kryetari i BM, z. Adrian Thano, pasi verifikon se është plotësuar kuorimi i nevojshëm, deklaron të hapur mbledhjen rreth orës 14:00.

Menjëherë Kryetari i jep fjalën Drejtorit Ekzekutiv z. Andi Kananaj i cili, pasi theksoi nevojën e strukturimit të stafit të AMShC- së në funksion të detyrave të Ligjit Nr. 119 datë 06.11.2015 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile", kërkoi të miratohet struktura e menduar e cila iu shpërnda të pranishmëve.

Në vijim të këtij komunikimi, Kryetari i Bordit Mbikqyrës dhe anëtarët e pranishëm u shprehën dakord në tërësi duke miratuar strukturën e re të AMShC- së.

Ky propozim u pranua nga anëtarët e pranishëm dhe Kryetari i Bordit Mbikqyrës i cili realizoi një konkludim të Mbledhjes së Bordit Mbikqyrës dhe miratimit të vendimit të marrë në këtë mbledhje si më poshtë vijon:

1. Miratimi i propozimeve mbi ndryshimet e strukturës së AMShC- së sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

Të gjithë anëtarët e pranishëm aprovuan dhe firmosën për vendimin e marrë në këtë mbledhje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHQËRISË CIVILE

Mbledhja u mbyll në orën 15:00.

Për Bordin Mbikqyrës të AMShC- së:

1. Z. Adrian THANO

Kryetar

2. Znj. Majlinda Dhuka

NënKryetare

3. Z. Alban DUDUSHI

Anëtar

4. Znj. Albana Koçiu

Anëtare

5. Z. Aldo MERKOCI

Anëtar

6. Z. Endri FUGA

Anëtar

7. Znj. Gelardina PRODANI

Anëtare

8. Z. Ismail ADEMI

Anëtar

9. Znj. Kozara KATI

Anëtare

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Struktura Organizative e AMSHC sipas VKM- së Nr. __ datë __. __.

